



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGIISE

VENDIM

Nr. 159 Datë 21.11.2012

**MBI KËRKËSËN E SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE PËR RINOVIM
TË LICENSËS “PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME
PAKICË TË ENERGIJË ELEKTRIKE” ME NR 68, SERIA P08FPP TË
MIRATUAR ME VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 09,
DATË 25.01.2008 DHE NR. 58, DATË 03.06.2008**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “dh”, 9; 13, pika 1, gërmat “c” dhe “ç” dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 23 të Ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, neneve 5, pika 1 gërma “e”, 13, dhe 16 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.11.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a për Rinovimin e Licencës për Aktivitetin e Furnizimi Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencave dhe Monitorimit të Tregut,

Vendosi :

1. Të pezullojë procesin e shqyrtimit të kërkesës për rinovimin e licencës në aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të energjisë elektrike për shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a, deri në arritjen e një zgjidhjeje përfundimtare nga ana e Grupit Negociator të ngritur pranë METE-s për zgjidhjen e çështjes me CEZ A.S dhe marrjes së një vendimit përfundimtar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-së në lidhje me procesin e filluar për heqje të licencave shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI